



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:226442
Datë: 10.12.2024
Numri i dokumentit: 06572312

C-IV-13-1520

Parashtruesi i kërkesës

R A G fshati R i V, Lipjan

Kundër

Pala kundërshtare

Agjencioni Kosovar i Privatizimit- AKP (NSH - Mbushtorja e Pijeve “Coca Cola” në likudim), Rr. “Dritan Hoxha” 55, Lakrishte, Prishtinë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), sipas gjyqtarit Gazmend Sylaj, me 10 dhjetor 2024, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

- I. Ankesa e ankuesit refuzohet si e pabazuar.**
- II. VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN007-0065 datë 4 korrik 2013.**
- III. Nuk caktohen shpenzime gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 13 gusht 2013, pranë DHPGJS është parashtruar një kërkesë, e emërtuar padi, për rishikimin e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit (tani e tutje AL) PRN007-0065 datë 4 korrik 2013 (tani e tutje Vendimi), me të cilin kërkesa kreditore e ankuesit mbi kompensimin e 3 pagave të papaguara, në shumë prej 405.00 (katër zero pesë) Euro, ndaj NSH “Mbushtorja e Pijeve -Coca Cola”, është refuzuar si e pas-afatshme.

Fillimisht ankuesi përfaqësohej nga avokati I D.

Kërkesës për rishikim nuk i është bashkangjitur Vendimi i AL.

Ankuesi kundërshtoj vendimin duke pohuar si i është përmbajtur afateve.

Ankuesi më tutje pohon se nuk qëndron arsyetimi i vendimit mbi faktin se kërkesa e tij kreditore është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit të punës së bashkuar – LPB.

Me 13 shkurt 2014, gjykata lëshoj një urdhëresë për ankuesin nga i cili u kërkua që të parashtrroj, kopjen e vendimit ndaj së cilit është ushtruar ankesa, kopjen e autorizimi për përfaqësuesin dhe përkthimin në gjuhën Angleze të ankesës.

Urdhri i lartcekur nuk është përmbushur.

AKP, me 10 janar 2018, parashtrroj përgjigjen.

AKP e kundërshtoj në tërësi pohimet e ankuesit si të pabazuara. AKP informoj gjykatën se ankuesi kërkesën e tij kreditore pranë AL e ka parashtruar me 8 mars 2006 gjersa afati ishte gjer me datën 5 shkurt 2006. AKP pohon se AL ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar në mënyrë të drejtë. Tutje, AKP, pohoj se kërkesa për rishikim nuk përmban argumentet e saj ligjore ashtu siç parashihet sipas dispozitave ligjore të Ligjit për AKP. Përfundimisht AKP pohon se kërkesa është e parashkruar në kuptim të dispozitave të Ligjit mbi punën e bashkuar – LPB. Nga të gjitha arsyet e cekura, AKP propozon që kërkesa për rishikim të refuzohet si e pabazuar dhe të vërtetohet Vendimi i AL.

Përgjigja e AKP ju dorëzua ankuesit me 17 janar 2018.

Ankuesi nuk parashtror përgjigje.

Me urdhrin e dytë, të gjykatës, ankuesit ju kërkua që të parashtror kopjen e Kopjen e Vendimit të AL.

Ankuesi përmbushi urdhrin.

Arsyetimi Ligjor

Ankesa është e pabazuar.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit Nr.06/L-086 të DHPGJS në lidhje me nenin 399 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, Gjykata përcakton se faktet relevante të rastit janë të pakontestueshme dhe nxjerrë këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Ankuesi e ka dorëzuar kërkesën pranë Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë jashtë afatit ligjor të shpallur nga ana e Agjencisë-së për parashtrimin e kërkesave kreditore. Në bazë të Vendimit të Bordit të Agjencisë, datë 16 nëntor 2005, ndërmarrja -NSH kishte hyrë në proces të likuidimit nga data 17 nëntor 2005. Agjencia kishte publikuar njoftimin për fillimin e likuidimit të NSH-së, ku edhe kishte njoftuar të gjithë kreditorët potencial të NSH se afati për parashtrimin e kërkesave është deri me datën 5 shkurt 2006.

Ankuesi kërkesën e tij Autoritetit të Likuidimit ia kishte parashtruar me datë 8 mars 2006.

Nga kjo konstatohet se ankuesi kërkesën e tij tek Autoriteti i Likuidimit e kishte parashtruar pasi që kishte kaluar afati i parashtrimit të kërkesave sipas informimit të bërë nga AKM-ja. Ankuesi nuk ka sjell asnjë dëshmi të besueshme që do ta justifikonte vonesën e tij në parashtrimin e kërkesës te Autoriteti i Likuidimit, mandej nuk është ndalur fare në arsyetimin e vonesës.

Nga data e fundit për parashtrimin e kërkesave 5 shkurt 2006, e deri në datën e parashtrimit të kërkesës së tij me 8 mars 2006 në Autoritetin e Likuidimit, kanë kaluar më tepër se një muaj. Andaj, kërkesa dorëzuar në AL me një vonesë të tillë me të drejtë është refuzuar si e pavlefshme, si rrjedhojë e saj edhe ankesa, e emërtuar si padi, e parashtruar në DHPGJS kundër vendimit në fjalë refuzohet si e pabazuar.

Neni 37.4.4.1 i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit përcakton se kërkesat që konsiderohen të jenë të pas-afatshme sipas afatit të kufizuar të përcaktuar me ligjet e aplikueshme si dhe kërkesat që nuk janë parashtruar në mënyrë të rregullt apo me kohë, refuzohen.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksa Gjyqësore:

Në pajtim me nenin 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, nuk caktohen taksa gjyqësore, në këtë procedurë ankimore, pasi që vlera e kontestit është nën 1,000.00 Euro.

Në bazë të nenit 62.3 të Ligjit për DHPGJS secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për DHPGJS.

Gazmend Sylaj, Gjyqtar